Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. i prot 4745 Br. prot. Më Dt. 19.11.2020
RAHOVEC - ORAHOVAC

13 Nr. Zyrtar – 2020
Dt.: 19.11.2020

Bazuar në vendimin nr. 1427 të datës 30.04.2019 të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për themelimin e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi", Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS PËR KRIJIMTARI LETRARE

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, me synim të nxitjes së krijimtarisë letrare – artistike, fton krijuesit nga komuna e Rahovecit që të konkurrojnë me punimet e tyre letrare – artistike, në kuadër të shënimit të Ditës së Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi".

Ceremonia e ndarjes së Çmimit organizohet më 7 dhjetor 2020, në ditëlindjen e shkrimtarit Sulejman Krasniqi, emrin e të cilit e mban biblioteka komunale në Rahovec.

Vlerësimi bëhet nga njohës të fushës, (juria profesionale), që formohet nga organet drejtuese të Komunës së Rahovecit, e cila do të bëjë edhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare nga ana e pjesëmarrësve në konkurs.

→ Çmimi ''Sulejman Krasniqi'' shpërblehet me shumë të caktuar monetare, ndërsa rezultatet e konkursit publikohen më 7 dhjetor 2020, me rastin e Ditës së Bibliotekës komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec.

→ Për të gjithë pjesëmarrësit në këtë konkurs, Komuna e Rahovecit do të ndajë mirënjohje me qëllim të pasurimit të kulturës me krijime letrare të ndryshme. Konkursi ka për qëllim që të nxisë shoqërinë në Komunën e Rahovecit që të meren me poezi dhe krijimtari letrare dhe në të njëjtën kohë tu krijoj atyre hapësirë për promovimin e krijimtarive të tyre.

- Krijimtaria nuk preferohet të jetë më e gjatë se 4 faqe të formatit A4.
- Punimet dorëzohen në kopje fizike (tri kopje) në zarf të mbyllur dhe me shifër.
- Afati për dorëzimin e punimeve do të jetë nga data 19 nëntor 2020 deri me datë 3 dhjetor 2020.
- Adresa: Komuna e Rahovecit (DKRS)
- 21000 Rahovec
- Për Çmimin letrar "Sulejman Krasniqi"

Rahovec
Datë: 19.11.2020

Bjondina Kleqka

Drejtoreshë e DKRS-së